

MBLEDHJA E 15 E KE E LSHPM



VENDIME TË RËNDËSISHME PËR PUNËN NË VAZHDIM

Këshilli ekzekutiv i LSHPM më 17 nëntor të vitit 2017 ka mbajtur mbledhjen e 15 të rregullt me të cilën në mungesë të arsyeshme të kryetarit të LSHPM Dragi Argirovski ka udhëhequr nënkryetari i KE të LSHPM Salltir Karovski, ndërsa përveç anëtarëve kanë marrë pjesë edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM, Besnik Pocesta, kryetari i KE të LSHP të Qytetit të Shkupit Metodija Novkovski, kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacion Zdravko Petkovski dhe kryetari i Komisionit për jetë kulturore-argëtuese Mendo Dimovski. Si zakonisht fillimisht u miratua procesverbali i mbledhjes së kaluar të 14-të të KE të LSHPM. Pastaj u miratua Propozimi i Planit financiar për vitin 2018. Informacionin për garat e mbajtura të 22-ta republikane sportive të pensionistëve ka dhënë kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacione Zdravko Petkovski dhe u soll edhe vendim për shumën e çmimit për nikoqirin e

të plotësohet me aktivitete të caktuara aktuale. Në mbledhje anëtarët janë informuar për punën financiare të LSHPM për nëntë muajt e vitit 2017. Shpjegim të materialit të distribuar më herët ka dhënë kryetari i KP, Mitre Stojanovski. Analiza e të hyrave dhe të dalave të realizuara jep mesataren e gjendjes dhe orientime për organizim të mëtutjeshëm të aktiviteteve të mbështetura me konstruksion financiar. Nga materiali të qarta janë shumë drejtues të pozitiv për punë me përgjegjësi dhe realizim të planeve në kuadër të planit financiar për vitin 2017. Gjithashtu në mbledhje u miratua edhe Propozimi i Planit financiar për vitin 2018. Informacionin për garat e mbajtura të 22-ta republikane sportive të pensionistëve ka dhënë kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacione Zdravko Petkovski dhe u soll edhe vendim për shumën e çmimit për nikoqirin e

suksesshëm SHP Koçan. Informacion për pjesëmarrje në FZZHD e 17-të në Lubjanë dha Aleksandar Zahariev kryetari i SHP Shtip i cili potencoi se SHP Gjoçe Petrov dhe SHP Shtip me dinjitet kanë përfaqësuar LSHPM në FZZHD e 17-të në Lubjanë. Është sjellë edhe vendim për shumën e çmimit për pjesëmarrjen e suksesshme të këtyre dy shoqatave. Në mbledhje janë shqyrtuar edhe kërkesat për ndihmë financiare për hapjen e klubeve të pensionistëve në Delçevë dhe Kërçovë. Të pranishmit kanë qenë të njoftuar edhe për informacionin intern nga SHP Ohër dhe Debrçë dhe SHP Kisella Vodë është sjellë edhe vendim për mbajtje të Punëtorisë me korrespondentët e gazetave të LSHPM. Pas diskutimeve të vëllimshme për të gjitha pikat, në fund u sjell vendimi që më 22 dhjetor të mbahet mbledhje e Kuvendit të LSHPM. (K. S. Andonova)

SHP GAZI BABË

Shënimi solemn i jubileut 45 vjeçar

Në një ambient solemn dhe atmosferë të këndshme, më 12 dhjetor të vitit 2017 Shoqata e pensionistëve Gazi Babë, me një program të veçantë, ndërsa në prezencë të një numri të madh të anëtarëve dhe mysafirëve, në restorantin "Dalijsa", ka shënuar jubileun e madh, 45 vjetorin e ekzistimit të saj. Në solemnitët morën pjesë: Ministrija e punës dhe politikës sociale në Qeverinë e RM, Milla Carovska, nënkryetari Salltir Karovski dhe sekretari Stanka Trajkova e KE të LSHPM, kryetari i Këshillit ekzekutiv Metodija Novkovski dhe kryetari i Kuvendit të LSHP të Qytetit të Shkupit, Lupço Dimovski, kryetarë dhe përfaqësues të shoqatave të pensionistëve nga Shkupi, kryetarët e SHP Kumanovë, SHP Prilep, SHP Koçan, SHP Radovish dhe Konçe, kryetarët e shoqatave të pensionistëve nga Vranja e Serbisë dhe Pernik e Bullgarisë, si dhe një numër i madh i pensionistëve nga SHP Gazi Babë. Gjatë ardhjes, mysafirët janë pritur dhe shërbyer me bukë e kripë, nga ana e pensionistëve të shoqatës të veshura me veshje kombëtare. Pasi kori pranë SHP Gazi Babë, këndoi këngën solemne, nën udhëheqjen e Millo-rad Iliqit—Rades, fjalë përshëndetëse kishte Gjorgje Andonov, kryetari i SHP Gazi Babë, i cili u dëshiroi mirëseardhje dhe shëndet të mirë të gjithë të pranishmëve dhe mes tjerash tha:

"Jemi të bindur se, sikurse edhe

deri tani, do të vazhdojmë të gjithë së bashku të punojmë në interes të pensionistëve, sepse vetëm në atë mënyrë do ta bëjmë Shoqatën edhe më të mirë edhe më të fortë. Sikurse edhe deri tani do të punojmë pandërprerë në drejtim të përforsimit të pozitës sonë në shoqëri dhe do të mundohemi të jemi në mesin e më të mirëve dhe të denjë për respekt shoqëri, anëtare të LSHPM", theksoi Gjorge Andonov. Pastaj të pranishmit u njoftuan me sukseset dhe të arriturat e shoqatës në vitet e kaluara. Urimet me rastin e jubileut deri tek pensionistët e SHP Gazi Babë dhe përshëndetje deri tek të gjithë të pranishmit dërgoi ministrija e punës dhe politikës sociale, Milla Carovska, nënkryetari i KE pranë LSHPM, Salltir Karovski, përfaqësues nga SHP Kumanovë, SHP Vranje dhe SHP Pernik. Në kuadër të solemnitetit, ministrisë së punës dhe politikës sociale, LSHPM, Lidhjes së qytetit, Kuvendeve të komunave Gazi Babë, Petrovec dhe Haraçinë, Shoqatave të pensionistëve të Shkupit dhe brendisë, SHP Vranje dhe SHP Pernik, si dhe shumë organizatave, mes të cilave edhe Kryqit të Kuq pranë komunës Gazi Babë, u janë ndarë pllaketa dhe mirënjohje, ndërsa sportistëve dhe aktivistëve pranë shoqatës, u janë ndarë mirënjohje për afirmim të shoqatës. Takimi vazhdoi me muzikë, valle dhe shoqërim të përbashkët. (Vasil Paçemski)



Më 21 nëntor 2017, SHP Tetovë mbajti mbledhjen e kuvendit në të cilin u bë përmbledhja e arritjeve dhe rezultateve të punës njëvjeçare të organeve dhe trupave të Shoqatës dhe në të njëjtën kohë u shqyrtuan preokupimet për vitin 2018 që po vjen.

"Materialet e parashtruara përmbajtësisht janë propozime konkrete dhe dispozita programore në të cilat do të përpiqen për të

praktikuar forma masive të pjesëmarrjes së pensionistëve nëpërmjet të cilave sigurohet relaksim dhe rritje e jashtëzakonshme e problemeve të njerëzve të moshës së tretë. Ne do të pasurojmë bashkëpunimin me organet e pushtetit lokal në gjashtë komunitat në territorin e së cilës vepron SHP Tetovë, për realizimin e më shumë të drejtave të pensionistëve në vendet e banimit të përher-

SHP TETOVË

Përcaktimet e arritura të programit

shëm. Pastaj ne do të realizojmë përmbajtjen e pasuruar të bashkëpunimit me shoqatat e tjera, organizatat joqeveritare, asociacionet tjera, dhe do të përpiqemi për lidhje më të ngushta me shoqatat e ngjashme në vendet fqinje, në mënyrë aktive duke marrë pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar dhe afrim të ndërsjellë", u tha nga Stojan Sokolovski, kryetari i Kuvendit të SHP Tetovë, në mbledhjen ku u shqyrtuan dhe miratuan Raporti për punën njëvjeçare, Programi i aktiviteteve për vitin e ardhshëm dhe plani për punën financiare materiale në vitin 2018. Në mbledhje morën pje-

së edhe mysafirë nga Prizreni dhe Obiliqi i Kosovës, si dhe shoqatat e Kostivarit, Sarajit, Tavtlixhes dhe Dibrës. Seancën e përcolli dhe mori pjesë në mënyrë aktive edhe Besnik Pocesta, Kryetari i Kuvendit të LSHPM.

Në diskutim morën pjesë disa delegatë të Kuvendit të cilët në thelb i përrollën përshtypjet dhe mendimet mbi materialet që u shqyrtuan nga degët. Në të gjitha mjediset, edhe në seancë u konstatua se angazhimet e programit të vitit që po kalon janë realizuar dhe formojnë bazën për aktivitetin e ardhshëm. Në seanca u aktualizua edhe nevoja për ndërtimin e

një shtëpie për të moshuarit, hapje të klube në zonat e qytetit dhe zonave të mëdha rurale, masa për ruajtjen e shtëpisë së përhershme të pensionistëve dhe të tjera. Kryetari Besnik Pocesta shprehu kënaqësi të madhe në lidhje me përmbajtjet e materialeve të prezantuara, duke përcjellë qëndrimin e LSHPM se kjo Shoqatë është ndër më aktivet dhe më mirë të organizuara. Anëtarët e Kuvendit sollën vendim që SHP Tetovë të nënshkruajë një memorandum bashkëpunimi të zgjeruar me organizatat pensionistëve nga Prizreni dhe Obiliqi i Kosovës. (C. Eftovski)